

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Pikëllimi / *el-Huzn* / الحزن

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Për sa u përket kapitujve, ato janë dhjetë: pikëllimi, frika, ankthi, përlësia, kapitullimi, asketizmi, kujdesi me devocion, përkushtimi, shpresa, dhe aspirata.

Kaptina mbi pikëllimin¹

Allahu ﷻ thotë:

“... ata u kthyen me sytë e mbushur me lot nga pikëllimi ...” (et-Teube, 92)

Pikëllimi është ndjenja e agonisë për diçka që është humbur apo acarimi për diçka që s’mund të arrihet. Kjo ka tri nivele:

Pikëllimi i shumicës së besimtarëve është për:

- Pakujdesinë në shërbim (adhurim)
- Rënien në gjendjen e pështirë të pandjesisë (apatisë)²
- Humbjen e ditëve (kohës)³

¹ Ibn el-Kajjim në *el-Medaarixh* thekson se pikëllimi është një shkallë apo stacion nëpër të cilën kërkuesit do të kalojnë patjetër, ndonëse Allahu e nuk e kërkoi këtë prej tyre, nuk i nxiti që ta kërkonin e as nuk dëshiroi që ata të qëndrojnë në të. Në fakt, pikëllimi nuk përmendet në Kuran ndryshe veçse në kontekstin e ndalimit dhe qortohet si i pavend për besimtarët. *Ferah* (gëzimi) përmendet në ajete të ndryshme si diçka e dëshirueshme dhe e dënueshme, kështu që kemi të bëjmë me një lloj të caktuar të gëzimit që Allahu do prej nesh. Sidoqoftë, kërkuesit e shtegut të pastrimit shpirtëror në dynja, do të kalojnë patjetër nëpër shkallën e pikëllimit, për shkak të natyrës që ka pikëllimi dhe për shkak të dobësisë së vetë tyre. Megjithatë, ata duhet ta kërkojnë ndihmën e Allahut për të dalë nga pikëllimi në shkallët e pranimit (*rida*), të prehjes (*tuma’niineh*), dhe të gëzimit (*surûr*).

² Kur gjynahet të largojnë nga Allahu apo kur pandjesia të shtyn në gjynahe dhe në mangësi.

³ Pa kënaqësinë e arritjes së kënaqësisë së Tij.

Pikëllimi i elitës së besimtarëve apo e të qëndrueshmëve është për:

- Humbjen e kohës në shpërhapje⁴
- Preokupimin me tjetër gjë veç të parët e (caktimeve të) Zotit
- Heqjen e vëmendjes nga pikëllimi⁵

Ajka e elitës së besimtarëve s'kanë të bëjnë me pikëllimin. Megjithatë, mund të thuhet se niveli i tretë i pikëllimit është:

- Pikëllimi për shkak të ndryshimit të gjendjeve⁶, jo thjesht të mendimeve
- Pikëllimi për synimet kontradiktore⁷
- Pikëllimi për mospajtimin me caktimet⁸

⁴ Shpërhapja në luginën e kotësisë. Bashkimi i zemrës do të jetë vetëm me Krijuesin e saj, jo me gjëra të tjera.

⁵ Kur shkëlqimi i dynjasë t'i mbizotërojë mendimet. Mund të ndodhë që pikëllimi për kotësitë të ta heqë vëmendjen nga pikëllimi i lavdëruar.

⁶ Kjo është kur të jesh në një gjendje miqësie me Allahun, pastaj të të kaplojë befasi një gjendje respekti; apo një gjendje frike ta tejkalojë atë të shpresës.

⁷ Kjo është kur ta kesh vështirë të zgjedhësh mes synimeve kontradiktore, të konstatosh çka është më e kënaqshme për Allahun, të jesh i paanshëm, dhe të arrish të ikësh nga nxitjet e vetvetes (*egos / nefsit*).

⁸ Këto mund të jenë urdhrat e Allahut apo caktimet e Tija universale. Vërejtje ndaj urdhrit në këtë nivel ndodh atëherë kur të hiqesh nga gjendja (*haal*) me anë të një urdhri dhe të ndiesh rezistencë në zemër ndaj lënies së gjendjes për pajtimin me urdhrin. Në këtë rast, duhet t'i japësh përparësi dijes së Shpalljes. Vërejtja apo mospajtimi me caktimin universal në këtë nivel ndodh thjesht vetëm duke dëshiruar të jesh ndryshe. Dikujt mospajtimi mund t'i ndodhë nga dështimi për t'u strehuar menjëherë në shkallën apo stacionin e pranimit (*rida*).